

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Menaxhimi i Performancës

P8

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data
Date

11.02.2023

CONTENT / PËRMBAJTJA

SESSION	MAXIMUM ASSIGNED	<u>-ATTENTION!</u> <u>THIS PART IS</u> <u>FOR SCAAK</u> <u>USE ONLY-</u> MARKS
1. Problem 1	20	
2. Problem 2	20	
3. Problem 3	20	
4. Problem 4	20	
5. Problem 5	20	
Total	100	

Pjesa	Maksimumi i dhënë	<u>-Kujdes! Kjo pjesë</u> <u>është vetëm për</u> <u>përdorim nga</u> <u>ShKÇAK-</u> PIKËT E DHËNA
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
Total	100	

Problemi 1

Personeli përgjegjës i Kompanisë 'Liquid' e cila e prodhon Produktin X, ka zhvilluar buxhetin për janar 2023 në bazë të standardeve të përdorura gjatë vitit 2022 të paraqitura në vijim:

Përdorimi standard i materialeve për njësi	125 litra
Çmimi standard i materialit	€215 për m ³ (1 m ³ = 1,000 litra)
Koha standarde e punës direkte për njësi	1.25 orë
Norma standarde e punës direkte për orë	€14

Në fund të dhjetorit të vitit 2022, gjatë procesit të mirëmbajtjes së përgjithshme vjetore janë mbyllë rrjedhjet nëpër tubacione që kanë ndikuar në të kaluarën në humbjen e lëndës së parë gjatë procesit të prodhimit dhe gjithashtu ka kërkuar angazhimin e punëtorëve që gjatë punës të bëjnë pastrimin e këtyre rrjedhjeve për të mos i penguar në punë. Këto riparime kanë ndikuar në shfrytëzimin më racional të lëndës së parë dhe efikasitetin e punëtorëve andaj është ri-shikuar përdorimi i materialit dhe koha e nevojshme e prodhimit për njësi të Produktit X. Vendimet e bëra nga menaxhmenti tregojnë si më poshtë:

Përdorimi i rishikuar i materialeve për njësi	115 litra
Koha e rishikuar e punës direkte për njësi	1.10 orë

Problemet me furnizime të shkaktuara nga kriza e luftës në regjion dhe Ligji i ri mbi pagat kanë detyruar menaxhmentin që gjithashtu të lejojnë edhe rishikimin e çmimit të blerjes së lëndës së parë dhe normës për orë të punës direkte duke vendosur:

Çmimin e rishikuar të materialit	€240 për m ³ (1 m ³ = 1,000 litra)
Normën e rishikuar të punës direkte për orë	€16

Rezultatet aktuale në 31 janar 2023 tregojnë si më poshtë:

Prodhi aktual	5,400 njësi të Produktit X
Përdorimi aktual i materialit	648 m ³
Kostoja aktuale e materialeve të përdorura	€145,800
Orët aktuale të punuara	6,500 orë
Kostoja aktuale e orëve të punuara	€97,500

Kërkohet:

- a.** Llogaritni mospërputhjet bazë të materialit: të çmimit, përdorimit dhe totale **3 pikë**
- b.** Llogaritni mospërputhjet bazë të punës; të normës, efikasitetit dhe totale **3 pikë**
- c.** Llogaritni mospërputhjet e planifikimit dhe të operacioneve për materiale **5 pikë**
- d.** Llogaritni mospërputhjet e planifikimit dhe të operacioneve për punë direkte **5 pikë**
- e.** Tregoni shkurtimisht ndërlidhjet në mes të mospërputhjeve bazë dhe mospërputhjeve të planifikimit dhe të operacioneve si për materiale ashtu edhe për punë direkte **4 pikë**

Zgjidhjet

a. Llogaritni mospërputhjet bazë të materialit: e çmimit, përdorimit dhe totale

Mospërputhja e çmimit e materialit:

648 m ³ të materialeve × 215 €/m ³ duhet të kishin kushtuar	€139,320	
por kanë kushtuar	€145,800	
Mospërputhja e çmimit e materialit	€6,480 PF	1 pikë

Mospërputhja e përdorimit e materialit:

5,400 njësi duhet të kishin përdorur (× 0.125 m ³)	675 m ³	
por kanë përdorur	648 m ³	
Mospërputhja e përdorimit në m ³	27 m ³ F	
× kostoja standarde për m ³	€215	
Mospërputhje e përdorimit në €	€5,805 F	1 pikë

Mospërputhja totale e materialit:

(5,400 njësi × 0.125 m ³ /njësi) × 215 €/m ³ duhet të kishin kushtuar	145,125	
por kanë marrë 648 m ³ që kanë kushtuar	145,800	
Mospërputhja e totale e materialit	(€6,480 PF + €5,805 F)	€675 PF

1 pikë

b. Llogaritni mospërputhjet bazë të punës; totale, të normës dhe efikasitetit

Mospërputhja e normës së punës:

6,500 orë të punës × 14 €/orë duhet të kishin kushtuar	€91,000	
por kanë kushtuar	€97,500	
Mospërputhja e normës së punës	€6,500 PF	1 pikë

Mospërputhja e efikasitetit të punës:

5,400 njësi × 1.25 orë, duhet të kishin përdorur	6,750 orë	
por kanë përdorur	6,500 orë	
Mospërputhja e efikasitetit të punës në orë	250 orë F	
× norma standarde për orë	€14	
Mospërputhje e efikasitetit të punës në €	€3,500 F	1 pikë

Mospërputhja totale e punës:

(5,400 njësi × 1.25 orë) × 14 €/orë duhet të kishin kushtuar	€94,500	
por kanë marrë 6,500 orë që kanë kushtuar	€97,500	
Mospërputhja e totale e punës	(€6,500 PF + €3,500 F)	€3,000 PF

1 pikë

c. Llogaritni mospërputhjet e planifikimit dhe mospërputhjet operationale të materialit

Mospërputhja e planifikimit e çmimit të materialit

648 m ³ × 215 €/m ³ (sipas çmimit standard)	139,320	
648 m ³ × 240 €/m ³ (sipas çmimit të rishikuar)	155,520	
Mospërputhja e planifikimit të çmimit të materialit	€16,200 PF	1 pikë

Mospërputhja e operationeve e çmimit të materialit

648 m ³ × 240 €/m ³ (sipas çmimit të rishikuar) duhet të kushtojë	155,520	
por kanë kushtuar	145,800	
Mospërputhja e operationeve të çmimit të materialit	€9,720 F	1 pikë

Mospërputhja e planifikimit e përdorimit të materialit

5,400 njësi × 0.125 sipas përdorimit standard duhet të përdorin	675 m ³	
5,400 njësi × 0.115 sipas përdorimit të rishikuar duhet të përdorin	621 m ³	
Mospërputhja e planifikimit e përdorimit të materialit në m ³	54 m³ F	½ pikë
Çmimi standard fillestar për m ³ të materialit	€215	
Mospërputhja e planifikimit e përdorimit të materialit në €	€11,610 F	1 pikë

Mospërputhja e operacioneve e përdorimit të materialit

5,400 njësi × 0.115 sipas përdorimit të rishikuar duhet të përdorin	621 m ³	
Por kanë përdorur	648 m ³	
Mospërputhja e operacioneve e përdorimit të materialit në m ³	27 m³ PF	½ pikë
Çmimi standard fillestar për m ³ të materialit	€15	
Mospërputhja e operacioneve e përdorimit të materialit në €	€5,805 PF	1 pikë

d. Llogaritni mospërputhjet e planifikimit dhe mospërputhjet operationale të punës

Mospërputhja e planifikimit e normës së punës

6,500 orë × €14 (sipas normës standarde)	€91,100	
6,500 orë × €16 (sipas normës së rishikuar)	€104,000	
Mospërputhja e planifikimit të normës së punës	13,000 PF	1 pikë

Mospërputhja e operacioneve e normës së punës

6,500 orë × €16 sipas normës të rishikuar duhet të kushtojnë	€104,000	
por kanë kushtuar	€97,500	
Mospërputhja e operacioneve të normës së punës	€6,500 F	1 pikë

Mospërputhja e planifikimit e efikasitetit të punës

5,400 njësi × 1.25 orë sipas standardit fillestar duhet të përdorin	6,750 orë	
5,400 njësi × 1.10 orë sipas standardit të rishikuar duhet të përdorin	5,940 orë	
Mospërputhja e planifikimit e efikasitetit të punës në orë	810 orë F	½ pikë
Norma standarde fillestare për orë të punës	€14	
Mospërputhja e planifikimit e efikasitetit të punës në €	€11,340 F	1 pikë

Mospërputhja e operacioneve e efikasitetit të punës

5,400 njësi × 1.10 orë sipas standardit të rishikuar duhet të përdorin	5,940 orë	
por kanë përdorur	6,500 orë	
Mospërputhja e operacioneve e efikasitetit të punës në orë	560 orë PF	½ pikë
Norma standarde fillestare për orë të punës	€14	
Mospërputhja e operacioneve e efikasitetit të punës në €	€7,840 PF	1 pikë


e. Ndërlidhjet në mes të mospërputhjeve bazë, të planifikimit dhe të operacioneve

Mospërputhjet bazë zakonisht tregojnë ndryshimin në mes të rezultateve aktuale dhe rezultateve të pritshme të zhvilluara nga elementet standarde në formë të buxheteve.


Mospërputhjet totale të komponentëve si materialet apo puna direkte etj., mund të zbërthehen më tutje në mospërputhjet e elementeve përbërëse të tyre si p.sh. mospërputhja e çmimit dhe e përdorimit të materialet, mospërputhja e normës dhe e efikasitetit të puna direkte etj. Ky zbërthim e identifikon më mirë 'shkaktarin' e mospërputhjes respektivisht identifikon ndikimin e secilit element përbërës në mospërputhjen totale.

Zbërthimi i mëtejshëm i mospërputhjeve të çmimit dhe të përdorimit të materialeve, apo i mospërputhjeve të normës dhe të efikasitetit të punës direkte bëhet kur secilën prej këtyre

mospërputhjeve i ndajmë në mospërputhjet e planifikimit dhe mospërputhjet e operacioneve si për çmime dhe përdorim të materialeve ashtu edhe për normë dhe efikasitet të punës direkte. Kjo identifikon se cilët faktorë (të jashtëm apo të brendshëm), vendin (sipas strukturës organizative) dhe përgjegjësit për mospërputhjet e shkaktuara. Ndërlidhjet e formave të mospërputhjeve të materialeve dhe të punës direkte janë paraqitur në skemën në vazhdim,



Shuma e mospërputhjeve bazë të çmimit dhe përdorimit të materialeve është mospërputhja (bazë) totale e materialeve, respektivisht shuma e mospërputhjeve bazë e normës dhe efikasitetit të punës direkte është mospërputhja (bazë) totale e punës direkte, sepse janë pjesë të zbrërthyerë të një tërësie (totali).



Nga kjo rrjedh se edhe shuma e mospërputhjeve të planifikimit dhe të operacioneve, si elemente të zbërthyer, ndërlidhen me totalin përkatës të mospërputhje bazë nga i cili janë zbërthyer, si p.sh. shuma e mospërputhjeve të planifikimit dhe të operacioneve të çmimit të materialeve ndërlidhet dhe është e barabartë me mospërputhjen bazë të çmimit të materialeve apo shuma e mospërputhjeve të planifikimit dhe të operacioneve të normës së punës direkte ndërlidhet dhe është e barabartë me mospërputhjen bazë të normës së punës direkte e kështu me radhë (shih skemën më lartë për problemit e Kompanisë 'Liquid' dhe Produktin X të saj).

2 pikë

Problemi 2

Menaxheri i shitjes i Kompanisë 'Liquid', bazuar në kërkesat e klientëve propozon që një sasi e Produktit X të pakëtohet në bidonë prej 15 litrave. Për këtë qëllim, në bashkëpunim me departamentet e marketingut dhe furnizimit kanë bërë një hulumtim të cilin e kanë prezantuar para Bordit të Kompanisë.

Hulumtimi ka treguar se kërkesa për paketimin prej 15 litrave të Produktit X, mund të ndryshojë varësisht nga çmimi i shitjes. Rezultatet e hulumtimit lidhur me çmimin e shitjes dhe kërkesën janë përmbledhur në tabelën në vijim:

	<u>Çmimi</u>		<u>Kërkesa</u>
Nëse çmimi i shitjes është	€45	atëherë kërkesa pritët të jetë	5,500 njësi
Nëse çmimi i shitjes është	€48	atëherë kërkesa pritët të jetë	4,800 njësi
Nëse çmimi i shitjes është	€52	atëherë kërkesa pritët të jetë	3,900 njësi

Gjithashtu, është bërë edhe vlerësimi i kostos variabile, dhe varësisht nga lloji i materialit të bidonëve (plastikë, xham apo metal) kostot variabile për njësi vlerësohen në €29.00, €33.00 apo €37.00.

Bordi i Kompanisë para se të bëjë vendimmarrjen lidhur me propozimin e bërë, **kërkohet**:

- a.** Të përgatitet tabela që tregon kontributin e pritur për të gjitha rezultatet e mundshme nga hulumtimi i bërë. **9 pikë**
- b.** Duke u mbështetur në informacionin nga tabela e kontributeve nga pika (a.) të shpjegohet se çfarë nënkuptohet me rregullat e vendimit (*maximax*, *maximin* dhe *minimax* i *pendimit*) dhe cilat janë rezultatet e pritura për secilën nga rregullat e vendimit në vazhdim:
- i.** maximax, **2½ pikë**
- ii.** maximin dhe **2½ pikë**
- iii.** minimax i pendimit. **6 pikë**

Zgjidhja

a. Tabela e kontributeve të pritura për secilin prej nëntë rezultateve të mundshme

<u>Çmimi i shitjes</u>	<u>€45</u>	<u>€48</u>	<u>€52</u>	
<u>Kosto variabile</u>				
€29	€88,000 ¹	€91,200 ⁴	€89,700 ⁷	
€33	€66,000 ²	€72,000 ⁵	€74,100 ⁸	
€37	€44,000 ³	€52,800 ⁶	€58,500 ⁹	9 × 1 = 9 pikë

Llogaritjet: (Çmimi i shitjes – kosto variabile) × numri i njësive

¹ $(45 - 29) \times 5,500 = €88,000$

² $(45 - 33) \times 5,500 = €66,000$

³ $(45 - 37) \times 5,500 = €44,000$

⁴ $(48 - 29) \times 4,800 = €91,200$

⁵ $(48 - 33) \times 4,800 = €72,000$

⁶ $(48 - 37) \times 4,800 = €52,800$

⁷ $(52 - 29) \times 3,900 = €89,700$

⁸ $(52 - 33) \times 3,900 = €74,100$

⁹ $(52 - 37) \times 3,900 = €58,500$

b. Rregullat e vendimit maximax, maximin dhe minimax të pendimit

Maximax - Kriteri maximax shikon rezultatet më të mira të mundshme. Maximax do të thotë 'maksimizimi i fitimit maksimal'. Vendimi me këtë rregull është që të zgjidhni alternativën që mund të sigurojë fitimin më maksimal të mundshëm.

Në rastin konkret zgjidhen kontributet maksimale për secilin çmim të shitjes që janë:

Maximax	<u>Çmimi i shitjes</u>	<u>€45</u>	<u>€48</u>	<u>€52</u>
	<u>Kosto variabile</u>			
	€29	€88,000 ¹	€91,200 ⁴	€89,700 ⁷
	€33	€66,000 ²	€72,000 ⁵	€74,100 ⁸
	€37	€44,000 ³	€52,800 ⁶	€58,500 ⁹

¹ €88,000 (për çmimin €45),

⁴ €91,200 (për çmimin €48),

⁷ €89,700 (për çmimin €52).

Kontributi më i lartë është €91,200 që i përgjigjet opsionit me çmimin €48, koston variabile €29 dhe numrin e njësive prej 4,800.

2½ pikë

Maximin - Rregulli i vendimit maximin është se vendimmarrësi duhet të zgjedhë alternativën që ofron rezultatin më pak të keq të mundshëm nga më të këqijtë. Kjo do të thotë zgjedhjen e alternativës që maksimizon fitimet minimale.

Në rastin konkret zgjidhen kontributet minimale për secilin çmim të shitjes që janë:

Maximin	<u>Çmimi i shitjes</u>	<u>€45</u>	<u>€48</u>	<u>€52</u>
	<u>Kosto variabile</u>			
	€29	€88,000 ¹	€91,200 ⁴	€89,700 ⁷
	€33	€66,000 ²	€72,000 ⁵	€74,100 ⁸
	€37	€44,000 ³	€52,800 ⁶	€58,500 ⁹

³ €44,000 (për çmimin €45),

⁶ €52,800 (për çmimin €48),

⁹ €58,500 (për çmimin €52).

Nga vlerat e kontributeve minimale, kontributi më i lartë është €58,500 që i përgjigjet opsionit me çmimin €52, koston variabile €37 dhe numrin e njësive prej 3,900.

2½ pikë

Minimax i pendimit - Rregulli minimax i pendimit synon të minimizojë pendimin (keqardhjen) nga marrja e vendimit të gabuar. Pendimi është humbja oportune përmes marrjes së vendimit të gabuar. Në rastin konkret rregulli i vendimit 'minimax i pendimit' duke u shërbyer me tabelën e kontributeve ku zgjidhen kontributet maksimale për secilin kosto variabile llogaritet si në vijim:

Minimax i pendimit	<u>Çmimi i shitjes</u>	<u>€45</u>	<u>€48</u>	<u>€52</u>
<u>Kosto variabile</u>				
€29		€88,000	€91,200	€89,700
€33		€66,000	€72,000	€74,100
€37		€44,000	€52,800	€58,500

Duke e marrë për bazë kontributin më të lartë që ndërlidhet me koston variabile, llogariten vlerat e pendimeve:

Llogaritja e pendimeve	<u>Çmimi i shitjes</u>	<u>€45</u>	<u>€48</u>	<u>€52</u>
<u>Kosto variabile</u>				
€29		€3,200	€0	€1,500
€33		€8,100	€2,100	€0
€37		€14,500	€5,700	€0
Vlerat më të larta të pendimeve sipas çmimit		€14,500	€5,700	€1,500

Në fund për secilën kategori të çmimit përzgjidhet vlera maksimale e pendimit (në rastin e konkret):

€14,500 për çmimin prej €45,

€5,700 për çmimin prej €48 dhe

€1,500 për çmimin prej €52)

dhe prej këtyre vlerave të pendimeve më të larta përzgjidhet alternativa me vlerën më të ultë të pendimit që është vlera €1,500 që i përgjigjet alternativës me çmimin €52, koston variabile €29 dhe numrin e njësive prej 3,900.

6 pikë

ose

duke i llogaritur vlerat e pendimeve të zërthyer sipas koston variabile si vijon:

Minimax i pendimit	<u>Çmimi i shitjes</u>	<u>€45</u>	<u>€48</u>	<u>€52</u>
<u>Kosto variabile</u>				
€29		€88,000	€91,200	€89,700
€33		€66,000	€72,000	€74,100
€37		€44,000	€52,800	€58,500

Në rastin kur kemi koston variabile prej €29, kontributet që rrjedhin sipas secilit çmim do të jenë:

€88,000 (për çmimin €45),

€91,200 (për çmimin €48), kontributi më i lartë,

€89,700 (për çmimin €52).

Përzgjidhet alternativa me kontributin më të lartë (€91,200) dhe duke e marrë për bazë këtë vlerë llogariten vlerat e pendimeve:

<u>Kosto variabile</u>	<u>Çmimi i shitjes</u>	<u>€45</u>	<u>€48</u>	<u>€52</u>
€29		€3,200 ¹	€0 ²	€1,500 ³

¹ €91,200 - €88,000 = €3,200,

² €91,200 - €91,200 = €0,

³ €91,200 - €89,700 = €1,500.

Në rastin kur kemi koston variabile prej €33, kontributet që rrjedhin sipas secilit çmim do të jenë:

€66,000 (për çmimin €45),

€72,000 (për çmimin €48),

€74,100 (për çmimin €52), kontributi më i lartë.

Përzgjidhet alternativa me kontributin më të lartë (€74,100) dhe duke e marrë për bazë këtë vlerë llogariten vlerat e pendimeve:

	<u>Çmimi i shitjes</u>	<u>€45</u>	<u>€48</u>	<u>€52</u>
<u>Kosto variabile</u>				
€33		€8,100 ⁴	€2,100 ⁵	€0 ⁶
⁴ €74,100 - €66,000 = €8,100,				
⁵ €74,100 - €72,000 = €2,100,				
⁶ €74,100 - €74,100 = €0.				

Në rastin kur kemi koston variabile prej €37, kontributet që rrjedhin sipas secilit çmim do të jenë:

€44,000 (për çmimin €45),

€52,800 (për çmimin €48),

€58,500 (për çmimin €52), kontributi më i lartë.

Përzgjidhet alternativa me kontributin më të lartë (€58,500) dhe duke e marrë për bazë këtë vlerë llogariten vlerat e pendimeve:

	<u>Çmimi i shitjes</u>	<u>€45</u>	<u>€48</u>	<u>€52</u>
<u>Kosto variabile</u>				
€37		€14,500 ⁷	€5,700 ⁸	€0 ⁹
⁷ €58,500 - €44,000 = €14,500,				
⁸ €58,500 - €52,800 = €5,700,				
⁹ €58,500 - €58,500 = €0.				

Bashkohen të gjitha vlerat e pendimeve në një tabelë ku identifikohen vlera më të larta të pendimit sipas çmimeve, dhe përzgjidhet alternativa me vlerën më të ultë të pendimit:

Llogaritja e pendimeve	<u>Çmimi i shitjes</u>	<u>€45</u>	<u>€48</u>	<u>€52</u>
<u>Kosto variabile</u>				
€29		€3,200	€0	€1,500
€33		€8,100	€2,100	€0
€37		€14,500	€5,700	€0
Vlerat më të larta të pendimeve sipas çmimit		€14,500	€5,700	€1,500

Problemi 3

Në fund të vitit 2022, personeli përgjegjës i Kompanisë 'Liquid' ka përgatitë buxhetin e vitit 2023 për Produktin Y dhe ka prezantuar atë para Bordit të Kompanisë. Sipas buxhetit të përgatitur planifikohet të prodhohen 60,000 njësi të Produktit Y që paraqet shfrytëzimin prej 75% të kapaciteteve prodhuese. Çmimi i buxhetuar i shitjes është €12.00 ndërsa kostoja e plotë e Produktit Y është €9.00.

Disa anëtarë të Bordit të Kompanisë kanë kërkuar që të bëhen buxhetet fleksibile për prodhimtarinë e Produktit Y në nivelin e shfrytëzueshmërisë të kapaciteteve prej 90% dhe 100%.

Të vetëdijshëm se rritja e kërkesës ndikon në rënien e çmimit të shitjes, personeli përgjegjës për përgatitjen e buxhetit bënë hulumtimet dhe llogaritjet e duhura dhe erdhën në përfundim se çmimi i shitjes prej €10.80 do të jetë për nivelin e shfrytëzimit të kapaciteteve prej 90% respektivisht €9.60 për shfrytëzimin e kapaciteteve prej 100%.

Kërkohet:

- a. Nëse kompania llogaritë marzhën në çmimin e shitjes dhe dëshiron të mbajë marzhën e njëjtë të llogaritët kostoja e synuar për njësi dhe kostoja e synuar totale e Produktit Y nëse bëhet shfrytëzimi i kapaciteteve të prodhimtarisë (dhe shitja) në nivelin prej 90% respektivisht, në nivelin prej 100%.

8 pikë

- b. Krahasoni fitimin ekzistues për njësi dhe fitimin ekzistues total me fitimet e synuara respektive (për 90% dhe 100% të shfrytëzimit të kapaciteteve) dhe rekomandoni se cili prej opsioneve krijon fitimin më të lartë për Kompaninë 'Liquid'.

8 pikë

- c. Bazuar në të rezultatet e fituara në pikat (a.) dhe (b.) tregoni dy arsye të uljes së kostos së plotë për njësi të Produktit Y në nivelet e shfrytëzimit të kapaciteteve të prej 90% dhe 100% krahasuar me koston e plotë fillestare në nivelin e shfrytëzimit të kapaciteteve të prej 75%.

4 pikë

Zgjidhja

a. Llogaritja e kostos së synuar për njësi dhe kostos së synuar totale

- Caktimi i marzhës për shitjet aktuale:

Çmimi i shitjes	€12.00
Kosto e plotë	€9.00
Vlera e marzhës	€3.00
% e marzhës $[(€3 \div €12) \times 100]$	25%

2 pikë

- Llogaritja e kostos së synuar për prodhimtarinë e shfrytëzimit të kapaciteteve prej 90% dhe 100%

Në fillim duhet llogaritur kapacitetin e plotë (100%) të prodhimtarisë të Produktit Y

Nëse prodhimtaria prej 60,000 njësive paraqet 75% të shfrytëzimit të kapaciteteve atëherë:

100% është i barabartë me 60,000 njësi $\div$ 75% = **80,000** njësi

ndërsa

90% është i barabartë me 80,000 njësi $\times$ 90% = **72,000** njësi

2 pikë

prej nga rrjedh se

	<u>72,000 njësi</u>	<u>80,000 njësi</u>
Çmimi i shitjes	€10.80	€9.60
Vlera e marzhës ($\times$ 25%)	€2.70	€2.40
Kostoja e synuar për njësi	€8.10	€7.20
Numri i njësive	$\times$ 72,000	$\times$ 80,000
Kosto e synuar totale	€583,200	€576,000

4 pikë

b. Krahasoni i fitimit ekzistues për njësi dhe total me fitimet e synuara për kërkesat respektive

	<u>Shfrytëzimi 75%</u>		<u>Shfrytëzimi 90%</u>		<u>Shfrytëzimi 100%</u>	
	<u>për njësi</u>	<u>60,000 njësi</u>	<u>për njësi</u>	<u>72,000 njësi</u>	<u>për njësi</u>	<u>80,000 njësi</u>
Shitjet	12.00	720,000	10.80	777,600	9.60	768,000
Kosto e synuar	<u>9.00</u>	<u>540,000</u>	<u>8.10</u>	<u>583,200</u>	<u>7.20</u>	<u>576,000</u>
Fitimi	3.00	180,000	2.70	194,400	2.40	192,000

6 pikë

Bazuar në llogaritjet e bëra për të realizuar fitimin më të lartë rekomandohet që të shfrytëzohet kapaciteti prej 90% respektivisht prodhimtaria e 72,000 njësive me çmimin e shitjes prej €10.80 sepse kjo sjell fitim total më të lartë për €2,400 ($€194,400 - €192,000 = €2,400$) se sa shfrytëzimi i kapaciteteve prej 100% ku bëhet prodhimtaria (dhe shitja) e 80,000 njësive me çmim të shitjes prej €9.60, respektivisht sjell fitim total më të lartë për €14,400 ($€194,400 - €180,000 = €14,400$) se sa shfrytëzimi i kapaciteteve prej 75% ku bëhet prodhimtaria (dhe shitja) e 60,000 njësive me çmim të shitjes prej €12.00.

2 pikë

c. Arsytet e uljes së kostos së plotë për njësi

Nisur nga të dhënat në dispozicion, ku mungojnë të dhënat për llojet, çmimin dhe sasinë e materialeve të përdorura, nivelin e shfrytëzimit të materialeve gjatë përdorimit të tyre, orët dhe efikasitetin e punonjësve, që përmes zvogëlimit apo edhe eliminimit të mbeturinave dhe të kohës boshe zakonisht mund të ndikohet në uljen e kostove dhe arritjen e kostos së synuar në rastin e uljes së kostos së plotë për njësi të Produktit Y (në rastin konkret) mund të ketë pas ndikim:

- shpërndarja e kostos totale fikse e cila mbetet e njëjtë në total në më shumë njësi (nga 60,000 në 72,000) e zvogëlon pjesën e kostos fikse për njësi që njëherit ndikon edhe në uljen e kostos së plotë për njësi
- rritja e prodhimtarisë (nga 60,000 në 72,000) kërkon blerje të sasive më të mëdha të materialeve që mund të ndikojë në plotësimin e kushteve për gëzimin e zbritjeve për blerje me shumicë që i ofron furnitori apo negocimin e çmimeve më të ulëta furnizuese për materialet e blera.

2 × 2 = 4 pikë

Problemi 4

Pjesë të të dhënave nga pasqyrat financiare të Kompanisë 'Liquid' për vitet 2021 dhe 2022 janë paraqitur në vazhdim:

	<u>Viti 2021</u>	<u>Viti 2022</u>
	<u>€ (.000)</u>	<u>€ (.000)</u>
a) <u>Të dhënat nga Pasqyra e fitimit dhe humbjes</u>		
Të hyrat nga shitja (Qarkullimi)	6,840	7,290
Kosto e shitjes (<u>shënimi 1</u>)	4,530	4,720
Fitimi bruto	2,310	2,570
Shpenzimet operative	645	728
Shpenzimet e interesit	103	101
Shpenzimet e tatimit	175	182
Dividendët preferencialë	120	120
Fitimi pas tatimit dhe dividendëve preferencialë (<u>shënimi 2</u>)	1,267	1,439
b) <u>Të dhënat nga Bilanci i gjendjes</u>		
i. <u>Pasuritë qarkulluese</u>		
Stoqet	439	413
Llogaritë e arkëtueshme (<u>shënimi 3</u>)	1,248	1,419
Investimet afat-shkurtra	190	284
Paraja e gatshme në bankë dhe në arkë (dorë)	222	296
	2,099	2,412
ii. <u>Llogaritë e pagueshme: shumat që duhet të paguhen brenda vitit</u>		
Kreditë dhe mbitërheqjet bankare	143	209
Tatimet e korporatës	270	218
Dividendët	140	128
Llogaritë e pagueshme (<u>shënimi 4</u>)	1,164	1,317
	1,717	1,872
Pasuritë qarkulluese neto (b.i. – b.ii.)	382	540
c) <u>Të dhënat nga Shënimet sqaruese</u>		
<u>Shënimet</u>		
¹ Struktura e kostove të shitjes - 70% variabile, 30% fikse - për të dy vitet		
² Numri i aksioneve të zakonshme	10,000	10,000
³ Llogaritë e arkëtueshme tregtare	927	987
⁴ Llogaritë e pagueshme tregtare	645	668

Kërkohet

Të llogariten për të dy vitet koeficientet në vazhdim:

- Koeficienti i fitimit bruto,
- Koeficienti i kontributit,
- Koeficienti i fitimit operativ (FPIT)
- Koeficienti i fitimit pas tatimit dhe dividendëve preferencialë
- Fitimi për aksion
- Koeficienti qarkullues,
- Koeficienti i shpejt,
- Ditët (periudha) e arkëtimit të LL/A,
- Ditët (periudha) e qarkullimit të stoqeve,
- Ditët (periudha) e pagesës së LI/P

(20 × 1) = 20 pikë

Shënim: Të rrumbullakohen rezultatet në dy decimale nga pika 'a. - g.', përveç pikës 'e.' të cilën e rrumbullakoni në katër decimale. Pikat 'h. - j.' të paraqiten pa decimale.

Zgjidhja

Llogaritja e treguesve financiar

a. Koeficienti i fitimit bruto

Formula: $(\text{Shitjet} - \text{Kostot e shitjes}) \div \text{Shitjet}$

Viti 2021 $(6,840 - 4,530) \div 6,840 = \mathbf{33.77\%}$

Viti 2022 $(7,290 - 4,720) \div 7,290 = \mathbf{35.25\%}$

b. Koeficienti i kontributit

Formula: $(\text{Shitjet} - \text{Kostot variabile}) \div \text{Shitjet}$

Viti 2021 $[6,840 - (4,530 \times 70\%)] \div 6,840 = \mathbf{53.64\%}$

Viti 2022 $[7,290 - (4,720 \times 70\%)] \div 7,290 = \mathbf{54.68\%}$

c. Koeficienti i fitimit operativ (FPIT)

Formula: $\text{Fitimi operativ (FPIT)} \div \text{Shitjet}$

Viti 2021 $(2,310 - 645) \div 6,840 = \mathbf{24.34\%}$

Viti 2022 $(2,570 - 728) \div 7,290 = \mathbf{25.27\%}$

d. Koeficienti i fitimit pas tatimit dhe dividendëve preferenciale

Formula: $\text{Fitimi pas tatimit dhe dividendëve preferenciale} \div \text{Shitjet}$

Viti 2021 $1,267 \div 6,840 = \mathbf{18.52\%}$

Viti 2022 $1,439 \div 7,290 = \mathbf{19.74\%}$

e. Fitimi për aksion

Formula: $\text{Fitimi pas tatimit dhe dividendëve preferenciale} \div \text{numri i AZ}$

Viti 2021 $1,267 \div 10,000 = \mathbf{0.1267}$

Viti 2022 $1,439 \div 10,000 = \mathbf{0.1439}$

f. Koeficienti qarkullues

Formula: $\text{Pasuria qarkulluese} \div \text{Detyrimet qarkulluese}$

Viti 2021 $2,099 \div 1,717 = \mathbf{1.22}$

Viti 2022 $2,412 \div 1,872 = \mathbf{1.29}$

g. Koeficienti i shpejt

Formula: $(\text{Pasuria qarkulluese} - \text{Stoqet}) \div \text{Detyrimet qarkulluese}$

Viti 2021 $(2,099 - 439) \div 1,717 = \mathbf{0.97}$

Viti 2022 $(2,412 - 413) \div 1,872 = \mathbf{1.07}$

h. Ditët (periudha) e arkëtimit të LL/A

Formula: $(\text{LL/A tregtare} \div \text{Shitjet}) \times 365 \text{ ditë}$

Viti 2021 $(927 \div 6,840) \times 365 = \mathbf{49 \text{ ditë}}$

Viti 2022 $(987 \div 7,290) \times 365 = \mathbf{49 \text{ ditë}}$

i. Ditët (periudha) e qarkullimit të stoqeve

Formula: $(\text{Stoqet} \div \text{Kostot e shitjes}) \times 365 \text{ ditë}$

Viti 2021 $(439 \div 4,530) \times 365 = \mathbf{35 \text{ ditë}}$

Viti 2022 $(413 \div 4,720) \times 365 = \mathbf{32 \text{ ditë}}$

j. Ditët (periudha) e pagesës së LI/P

Formula: $(\text{LI/P tregtare} \div \text{Kostot e shitjes}) \times 365 \text{ ditë}$

Viti 2021 $(645 \div 4,530) \times 365 = \mathbf{52 \text{ ditë}}$

Viti 2022 $(668 \div 4,720) \times 365 = \mathbf{52 \text{ ditë}}$

20 × 1 = 20 pikë

Problemi 5

Të dhënat e paraqitura në vazhdim i përkasin Departamentit ABC të Kompanisë 'Liquid' që prodhon Produktet A, B dhe C:

	<u>Produkti A</u>	<u>Produkti B</u>	<u>Produkti C</u>	<u>Totali</u>
Njësi	4,200	6,300	10,500	21,000
Çmimi i shitjes (njësi)	87	71	59	
Kosto variabile (njësi)	62	56	49	
Kosto totale fikse				273,615

Kërkohet:

- a.** Të llogaritet numri i njësive të Produkteve A, B, dhe C për t'u arritur pika e rentabilitetit bazuar në të dhënat (sipas skenarit fillestar). Bazuar në këto të dhëna, sa do të jetë fitimi neto i departamentit nëse janë shitur të gjitha njësitë e Produkteve A, B dhe C? **6 pikë**
- b.** Sa do të jetë fitimi neto i departamentit nëse sipas skenarit të dytë shiten 10,500 njësi të Produktit A, 4,200 njësi të Produktit B, dhe 6,300 njësi të Produktit C? Sa njësi të Produkteve A, B, C duhen për t'u arritur pika e rentabilitetit sipas këtij skenari? **6 pikë**
- c.** Sa do të jetë fitimi neto i departamentit nëse sipas skenarit të tretë shiten 6,300 njësi të Produktit A, 10,500 njësi të Produktit B, dhe 4,200 njësi të Produktit C? Sa njësi të Produkteve A, B, C duhen për t'u arritur pika e rentabilitetit sipas këtij skenari? **6 pikë**
- d.** Të llogaritet numri i njësive të Produkteve A, B dhe C që përcaktojnë marginën e sigurisë për skenarin fillestar. **2 pikë**

Zgjidhja

a. Pika e rentabilitetit në njësi – skenari fillestar (i parë)

Përcaktimi i raportit të përzierjes të produkteve

	<u>Produkti A</u>	<u>Produkti B</u>	<u>Produkti C</u>
Prodhimtaria (shitja) në njësi	4,200	6,300	10,500
Raporti i përzierjes	2	3	5

Përzierja e produkteve përmbanë dy (2) njësi të Produktit A, tri (3) njësi të Produktit B dhe pesë (5) njësi të Produktit C.

Llogaritja e kontributit të përzierjes dhe kontributit mesatar të ponderuar

<u>Produkti</u>	<u>Kontributi për njësi</u>	<u>Numri i njësive në përzierje</u>	<u>Kontributi i përzierjes</u>
A	€87 - €62 = €25.00	2	€50.00
B	€71 - €56 = €15.00	3	€45.00
C	€59 - €49 = €10.00	5	€50.00
		10	€145.00

Kontributi mesatar i ponderuar = Kontributi i përzierjes ÷ numri i njësive në përzierje
= €145 ÷ 10 = **€14.5**

Llogaritja e pikës së rentabilitetit në njësi – Formula

Kostot totale fikse ÷ Kontributi i përzierjes

Pika e rentabilitetit (në njësi) = €273,615 ÷ €145
= **1,887 përzierje**

ose

Kostot totale fikse ÷ Kontributi mesatar i ponderuar

Pika e rentabilitetit (në njësi) = €273,615 ÷ €14.5
= **18,870 njësi totale të produkteve**

Llogaritja e njësive të produkteve individuale për pikën e rentabilitetit

<u>Produkti</u>	<u>Numri i përzierjeve</u>	<u>Numri i njësive në përzierje</u>	<u>Numri i njësive për pikën e rentabilitetit</u>
A	1,887	× 2	3,774 njësi
B	1,887	× 3	5,661 njësi
C	1,887	× 5	9,435 njësi
Numri total i njësive i të gjitha produkteve			18,870 njësi

ose

<u>Produkti</u>	<u>Njësi totale të produkteve</u>	<u>Pjesëmarrja e njësive në përzierje</u>	<u>Numri i njësive për pikën e rentabilitetit</u>
A	18,870	× (2/10)	3,774 njësi
B	18,870	× (3/10)	5,661 njësi
C	18,870	× (5/10)	9,435 njësi
Numri total i njësive i të gjitha produkteve			18,870 njësi

- Llogaritja e fitimit neto për 21,000 njësi

Llogaritja e kontributit të përgjithshëm

<u>Produkti</u>	<u>Njësive</u>	<u>Kontributi për njësi</u>	<u>Kontributi i përgjithshëm</u>
A	4,200	€25.00	€105,000
B	6,300	€15.00	€94,500
C	<u>10,500</u>	€10.00	<u>€105,000</u>
	21,000		€304,500

Llogaritja e fitimit neto

	<u>Vlera në €</u>
Kontributi i përgjithshëm	€304,500
Shpenzimet e përgjithshme fikse	<u>€273,615</u>
Fitimi neto	€30,885

6 pikë

b. Pika e rentabilitetit në njësi – skenari i dytë

Përcaktimi i raportit të përzierjes të produkteve

	<u>Produkti A</u>	<u>Produkti B</u>	<u>Produkti C</u>
Prodhimtaria (shitja) në njësi	10,500	4,200	6,300
Raporti i përzierjes	5	2	3

Përzierja e produkteve përmbanë pesë (5) njësi të Produktit A, dy (2) njësi të Produktit B dhe tri (3) njësi të Produktit C.

Llogaritja e kontributit të përzierjes dhe kontributit mesatar të ponderuar

<u>Produkti</u>	<u>Kontributi për njësi</u>	<u>Numri i njësive në përzierje</u>	<u>Kontributi i përzierjes</u>
A	€25.00	5	€125.00
B	€15.00	2	€30.00
C	€10.00	<u>3</u>	<u>€30.00</u>
		10	€185.00

Kontributi mesatar i ponderuar = Kontributi i përzierjes ÷ numri i njësive në përzierje
= €185 ÷ 10 = **€18.5**

Llogaritja e pikës së rentabilitetit në njësi – Formula

Kostot totale fikse ÷ Kontributi i përzierjes

Pika e rentabilitetit (në njësi) = €273,615 ÷ €185
= **1,479 përzierje**

ose

Kostot totale fikse ÷ Kontributi mesatar i ponderuar

Pika e rentabilitetit (në njësi) = €273,615 ÷ €18.5
= **14,790 njësi totale të produkteve**

Llogaritja e njësive të produkteve individuale për pikën e rentabilitetit

<u>Produkti</u>	<u>Numri i përzierjeve</u>	<u>Numri i njësive në përzierje</u>	<u>Numri i njësive për pikën e rentabilitetit</u>
A	1,479	× 5	7,395 njësi
B	1,479	× 2	2,958 njësi
C	1,479	× 3	<u>4,437 njësi</u>
	Numri total i njësive i të gjitha produkteve		14,790 njësi

ose

<u>Produkti</u>	<u>Njësi totale të produkteve</u>	<u>Pjesëmarrja e njësive në përzierje</u>	<u>Numri i njësive për pikën e rentabilitetit</u>
A	14,790	× (5/10)	7,395 njësi
B	14,790	× (2/10)	2,958 njësi
C	14,790	× (3/10)	<u>4,437 njësi</u>
	Numri total i njësive i të gjitha produkteve		14,790 njësi

- Llogaritja e fitimit neto për 21,000 njësi

Llogaritja e kontributit të përgjithshëm

<u>Produkti</u>	<u>Njësive</u>	<u>Kontributi për njësi</u>	<u>Kontributi i përgjithshëm</u>
A	10,500	€25.00	€262,000
B	4,200	€15.00	€63,000
C	<u>6,300</u>	€10.00	<u>€63,000</u>
	21,000		€388,500

Llogaritja e fitimit neto

	<u>Vlera në €</u>
Kontributi i përgjithshëm	€388,500
Shpenzimet e përgjithshme fikse	<u>€273,615</u>
Fitimi neto	€114,885

6 pikë

c. Pika e rentabilitetit në njësi – skenari i tretë

Përcaktimi i raportit të përzierjes të produkteve

	<u>Produkti A</u>	<u>Produkti B</u>	<u>Produkti C</u>
Prodhimtaria (shitja) në njësi	6,300	10,500	4,200
Raporti i përzierjes	3	5	2

Përzierja e produkteve përmbanë tri (3) njësi të Produktit A, pesë (5) njësi të Produktit B dhe dy (2) njësi të Produktit C.

Llogaritja e kontributit të përzierjes dhe kontributit mesatar të ponderuar

<u>Produkti</u>	<u>Kontributi për njësi</u>	<u>Numri i njësive në përzierje</u>	<u>Kontributi i përzierjes</u>
A	€25.00	3	€75.00
B	€15.00	5	€75.00
C	€10.00	<u>2</u>	<u>€20.00</u>
		10	€170.00

Kontributi mesatar i ponderuar = Kontributi i përzierjes ÷ numri i njësive në përzierje
= €170 ÷ 10 = **€17.0**

Llogaritja e pikës së rentabilitetit në njësi – Formula

Kostot totale fikse ÷ Kontributi i përzierjes

Pika e rentabilitetit (në njësi) = €273,615 ÷ €170
= **1,609.5 përzierje**

ose

Kostot totale fikse ÷ Kontributi mesatar i ponderuar

Pika e rentabilitetit (në njësi) = €273,615 ÷ €17.0
= **16,095 njësi totale të produkteve**

Llogaritja e njësive të produkteve individuale për pikën e rentabilitetit

<u>Produkti</u>	<u>Numri i përzierjeve</u>	<u>Numri i njësive në përzierje</u>	<u>Numri i njësive për pikën e rentabilitetit</u>
A	1,609.5	× 3	4,828.5 njësi
B	1,609.5	× 5	8,047.5 njësi
C	1,609.5	× 2	<u>3,219.0 njësi</u>
		Numri total i njësive i të gjitha produkteve	16,095.0 njësi

ose

<u>Produkti</u>	<u>Njësi totale të produkteve</u>	<u>Pjesëmarrja e njësive në përzierje</u>	<u>Numri i njësive për pikën e rentabilitetit</u>
A	16,095	× (3/10)	4,828.5 njësi
B	16,095	× (5/10)	8,047.5 njësi
C	16,095	× (2/10)	3,219.0 njësi
Numri total i njësive i të gjitha produkteve			16,095.0 njësi

- Llogaritja e fitimit neto për 21,000 njësi

Llogaritja e kontributit të përgjithshëm

<u>Produkti</u>	<u>Njësive</u>	<u>Kontributi për njësi</u>	<u>Kontributi i përgjithshëm</u>
A	6,300	€25.00	€157,500
B	10,500	€15.00	€157,500
C	<u>4,200</u>	€10.00	<u>€42,000</u>
21,000			€357,000

Llogaritja e fitimit neto

	<u>Vlera në €</u>
Kontributi i përgjithshëm	€357,000
Shpenzimet e përgjithshme fikse	<u>€273,615</u>
Fitimi neto	€83,385

6 pikë

d. Margjina e sigurisë – skenari fillestar (i parë)

Margjina e sigurisë në mjedisin me produkte të shumëfishta është e barabartë me shitjet e buxhetuara të përzierjes standarde minus shitjet në pikën e rentabilitetit (PR) të përzierjes standarde. Kjo duhet të shprehet në njësi të përzierjeve standarde (prej nga rrjedh numri i njësive të produkteve individuale) si përqindje e shitjeve të buxhetuara apo edhe në terma të të hyrave nga shitja.

- Përcaktimi i numrit të njësive të buxhetuara të përzierjeve standarde:

Formula: Përzierjet standarde të buxhetuara = Totali i njësive ÷ numri i njësive në përzierje

$$= (4,200 + 6,300 + 10,500) \div (2 + 3 + 5)$$

$$= 21,000 \div 10$$

$$= \mathbf{2,100 \text{ përzierje}}$$

- Përcaktimi i margjinës së sigurisë:

Formula: Margjina e sigurisë = Përzierjet standarde të buxhetuara - Përzierjet standarde në PR

$$= 2,100 \text{ përzierje} - 1,887 \text{ përzierje (të llogaritura në pikën (a.))}$$

$$= \mathbf{213 \text{ përzierje}}$$

- Llogaritja e njësive të produkteve individuale për margjinën e sigurisë

<u>Produkti</u>	<u>Numri i përzierjeve</u>	<u>Numri i njësive në përzierje</u>	<u>Numri i njësive për margjinën e sigurisë</u>
A	213	× 2	426 njësi
B	213	× 3	639 njësi
C	213	× 5	<u>1,065 njësi</u>
Numri total i njësive i të gjitha produkteve			2,130 njësi

2 pikë

ose

Formula: Margjina e sigurisë = Njësitet totale të buxhetuara – Njësitet totale në PR

$$= 21,000 \text{ njësi} - 18,870 \text{ njësi (të llogaritura në pikën (a.))}$$

$$= \mathbf{2,130 \text{ njësi}}$$

<u>Produkti</u>	<u>Njësi totale të produkteve</u>	<u>Pjesëmarrja e njësive në përzierje</u>	<u>Numri i njësive për marqjinën e sigurisë</u>
A	2,130	× (2/10)	426 njësi
B	2,130	× (3/10)	639 njësi
C	2,130	× (5/10)	<u>1,065</u> njësi
Numri total i njësive i të gjitha produkteve			2,130 njësi